

minierën e *Trepçës/Trepça*. Jetonte me familjen e vet. Familjarët e tij, së bashku me banorë të tjerë, e kanë braktisur Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze në verë të vitit 1998. Forcat serbe ishin të stacionuara në Fabrikën e Municionit. Fabrika ishte në afërsi të shtëpisë së tij dhe nga ajo shpesh dëgjoheshin të shtëna. Hamiti me djalin Hasanin dhe vëllain Halitin ndenjen në shtëpi. Kur forcat serbe kanë hyrë në **Prekaz të Poshtëm/Donje Prekaze më 22.09.1998**, në shtëpi qëlluan të ishin vetëm Hamiti dhe Haliti, sepse Hasani ka shkuar më herët me ushtarë të UÇK-së. Hamiti dhe Haliti u strehuan në pyllin e afërt. Pas pak, Hamiti doli për pak jashtë pyllit që të shihte nëse situata u qetësua. Në atë çast, aty pranë kaluan ushtarët serb me një tank. E morën Hamitin në tank dhe e çuan me vete. Nëntë ditë më vonë, më 2.10.1998, familjari i Hamitit, Qamili, e ka gjetur trupin e masakruar të Hamitit në pyll përmbi fshatin Mikushnicë/Mikušnica. E njohu në bazë të dokumenteve. Po atë ditë, Hamitin e kanë varrosur në varrezat e Prekazit të Poshtëm/Donje Prekaze.

**Burimet:** deklarata H.K, FDH-18197; deklarata N.K, FDH-18166; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256.

### Naim (Brahim) Haxhiu

(26.09.1972, shqiptar nga Tërncaci/Trnavce, komuna e Skënderajt/Srbica, student, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

### Kadri (Miftar) Mehmeti

(5.12.1974, shqiptar nga Prekazi i Epërm/Gornje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, teknik i ekonomisë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Naimi ka qenë absolvent i Fakultetit Ekonomik. Kadriu e kishte mbaruar shkollën ekonomike, ndërkaq punonte si punëtor ndërtimor. Ata dy ishin miq të mirë. Në datën **22.09.1998**, forcat serbe me tanke dhe autoblanda u nisën drejt Prekazit të Epërm/Gornje Prekaze. Popullata u strehua në pyjet e afërta. Naimi dhe Kadriu u nisën së bashku drejt pozicioneve të UÇK-së përmbi *Mëhallën e Fazli Demës [Prekaz i Epërm/Gornje Prekaze]*. Familjarët e tyre nuk kishin kurrfarë njohuri për ta për tri ditë rresht. Pas tërheqjes së forcave serbe më 25.09.1998, ushtarë të UÇK-së i kanë gjetur trupat e tyre të pajetë në një fushë të madhe në Prekazin e

Epërm/Gornje Prekaze. Që të dy u varrosën në varrezat e fshatit. Pas lufte, më 2.07.2001, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Naimit në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Tërncac/Trnavce.

**Burimet:** deklarata B.H, FDH-32462; deklarata M.M, FDH-16625; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### Shemsedin (Pajazit) Haxhiu

(15.05.1973, shqiptar nga Tërncaci/Trnavce, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Shemsedini me prindërit, motrat dhe vëllezërit e tij jetonin në Tërncac/Trnavce. Ka aderuar në UÇK në muajin prill të vitit 1998. Në datën **22.09.1998**, ai gjendej në pozicion te vendi i quajtur *Te vishnjat/Kod Višnje* në pyllin e **Prekazit të Epërm/Gornje Prekaze**. Rreth orës 14:30, Shemsedini me disa ushtarë dhe makinën e tipit *Lada Niva*, mbi të cilën ka qenë i montuar një mitraloz, u nisën drejt shkollës fillore. Përderisa makina po i afrohej shkollës, një prehdhë ka rënë pranë dhe e ka plagosur rëndë Shemsedinin. Edhe pse të plagosur lehtë, bashkëluftëtarët e bartën Shemsedinin në spitalin e UÇK-së në fshatin Gradicë/Gradica. Por, ai ndërroi jetë pas dy orësh. Po atë ditë, bashkëluftëtarët e kanë varrosur në atë fshat. Në datën 30.09.1998, trupin e tij e kanë rivarrosur në varrezat e Prekazit të Epërm/Gornje Prekaze. Pas përfundimit të luftës, më 2.07.2001, trupi i tij përfundimisht u varros në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Tërncac/Trnavce.

**Burimet:** deklarata B.H, FDH-32463; deklarata B.M, FDH-31868; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### Xhevxhet (Munish) Maliqi

(20.02.1977, shqiptar nga Prekazi i Epërm/Gornje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, student i makinerisë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Xhevxheti u bë pjesëtar i UÇK-së në fillim të vitit 1998. Para depërtimit të forcave serbe në Prekazin e Epërm/Gornje Prekaze, më **22.09.1998**, familja e Xhevxhetit u strehua në bjeshkën e *Çiçavicës/Čičavica*, ndërkaq ai shkoi që t'i bashkëngjitej njësitit